

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 124 Prot.

Tiranë, më 30.01 2017

VENDIM Nr. 9, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Kërkesën për shqyrtim të projektit "Mbi Rikonceptimin dhe Rivitalizimin e Qendrës së qytetit të Sarandës, rruga Flamurit"*, në zonat arkeologjike "A" dhe "B", subjekti JV "Ed Konstruksion & Fusha" sh.p.k. dhe Relacionin e verifikimit në terren, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. Të miratojë *projektin "Mbi Rikonceptimin dhe Rivitalizimin e Qendrës së qytetit të Sarandës, rruga Flamurit"* në zonat arkeologjike "A" dhe "B", subjekti JV "Ed Konstruksion & Fusha" sh.p.k. dhe Relacionin e verifikimit në terren, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit, të cilat janë punime sipërfaqësore dhe nuk prekin thellësinë e shtresave të tokës, për pjesën e mbetur të këtij projekti, nën monitorimin e DRKK Vlorë, Sektori i Sarandës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYEFAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO